



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data 27.01.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:“Blerje karburant ,vaj dhe graso për (Bashkin Roskovec, Ndërmarrjen e Pastrim Gjellbërimit Mirëmbajtjes Varrezave dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirmbajtjesë)”**i ndarë në lote:**

Loti 1 “Karburant për (Bashkin Roskovec,Ndërmarrjen e Pastrim Gjellbërimit Mirëmbajtjes Varrezave dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirmbajtjesë)”,

Loti 2 “Vaj dhe graso për (Bashkin Roskovec,Ndërmarrjen e Pastrim Gjellbërimit Mirëmbajtjes Varrezave dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirmbajtjesë)”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Karburante-0910000-0, Naftë-09134000-7,Vajra karburanti-09135000-4,Graso dhe lubrifikantë-24951000-5,Benzin-09132000-3.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 13 787 539 (trembëdhjetë milionë e shtatëqindë e tetëdhjetë e shtatëmijë e pesëqindë e tridhjetë e nëntë)lekë pa tvsh,ndarë në lote si më poshtë:

Loti 1-me fond limit prej: 13 127 939(trembëdhjetë milionë e njëqindë e njëzetë e shtatëmijë e nëntëqindë e tridhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.

Loti 2-me fond limit prej: me fond limit prej: 659 600 (gjashtëqindë e pesëdhjetë e nëntëmijë e gjashtëqindë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

- ❖ Për Loti 1 kriteret e kualifikimit si më poshtë: “Karburant për (Bashkin Roskovec, Ndërmarrjen e Pastrim Gjelbërimit Mirëmbajtjes Varrezave dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirëmbajtjes)”,

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

- a. Formulari i Ofertës sipas Shtojcës 1 & 1/1
- b. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit sipas Shtojcës 2;
- c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Këto kriteret janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kriteret janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e provës tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

a. Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 40, pika 5, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

. Keto kriteret vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesëmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më të ulët se 13 000 000 lekë pa tvsh. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. SHËNIM: Referuari pikës 8, të nenit 42, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Autoriteti/enti kontraktor përcakton se në rast se ofertuesi oferton për më shumë se një lotë atëherë vlera minimale e xhiros vjetore që operatori ekonomik duhet të paraqes do të jetë sa shumatorja e vlerave limit të loteve për të cilat OE oferton.

Argumentimi Ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2/b dhe 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Argumentimi i AK : Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2020, 2021 të paraqitur në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet , me nenshkrim dhe vule *Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*”.Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare*”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese.

3.Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 në zbatim të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia ROSKOVEC, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e

kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3. Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të lotit që po prokurohet, ose konkretisht në një vlerë jo më ulët se 5 000 000 lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 ose ekuivalente të vlefshëm që i referohet objektit të prokurimit.

Çertifikatat të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.

Argumentimi ligjor dhe i AK : Referuar nenit 40 pika 6/c, dhe 44 pika 1 të VKM 285 datë 19.05.2021. Ky certifikim tashmë një standart gjerësisht i kërkuar në fushën e prokurimeve publike, i mundëson AK për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë kontratën në mënyrë të cilësore. Ky kriter i siguron AK se OE që do të shpallet fitues është i certifikuar sipas këtij standarti, rezulton një kompani serioze e certifikuar në menaxhimin e cilësisë.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesemarres, duhet të jetë i pajisur me Licencë të tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) ose Autorizim për ushtrim aktiviteti “Tregti me pakice të lendeve djegëse Karburante”.

Argumentimi ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. **Kjo kerkese eshte nje paresore per AK si kriter i vecante i cilesise se mallrave qe prokurohen dhe affidabilitetit te Furnizuesit ne marredheniet kontraktuale per kete objekt prokurimi.**

2.3.4 Operatori ekonomik pjesemarres, duhet të paraqesë edhe deklaratat si më poshtë:

a) Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin me karburant, me pakicë, me shërbim 24 orë, për të gjitha mjetet e Bashkise Roskovec, me kartë elektronike të personalizuar, me targën e çdo automjeti dhe motorri të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

b) Operatori ekonomik duhet të deklarojë, se do të mbulojë furnizimin me karburant, nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, për të gjithë sasinë e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

c) Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër që të furnizojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit, si dhe pjesen e kërkuar nepermjet leshimit të tollonave, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Kartat elektronike dhe tollonat, duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme deri në përfundimin e levrimit të gjithë mallit përcaktuar në shtojcën 6.

d) Operoret ekonomike pjesëmarrës, duhet të deklarojnë se ofrojnë një ndërfaqe menaxhimi të karburanteve (Web-page), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit, të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Kjo ndërfaqe e menaxhimit të karburanteve (Web-page), duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori Ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogarija elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti Kontraktor. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit të disa raporteve, të cilat do të ndihmojnë AK për marrjen e vendimeve operacionale.

dh) Operatori ekonomik pjesemarres, duhet të ofrojë furnizimin me karburant me karta elektronike, të cilat duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme dhe gjatë vitit 2023 në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.561 datë 29.07.2016 **“Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme”**.

Argumentim: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-se që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë asetet elektronike të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë pike furnizimi me karburant, **që duhet të jetë në një distancë jo më të largët se 20 km nga vendndodhja e objektit të prokurimit**, vertetuar kjo me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate qiraje noteriale/ akt pronësie) **OSE duhet të paraqes një kontratë noteriale furnizimi me karburant të lidhur me një nga subjektet që disponojnë pikë karburanti që ushtrojnë aktivitetin brenda territorit të Bashkisë Roskove**

Argumentim : Ky kriter është vendosur duke u bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 5, e VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe duke marrë parasysh gjithashtu edhe mjetet e rënda teknologjike të cilat nuk mund të përshkojnë distanca të largëta rrugë pra ky kriter vendoset me qëllim për të favorizuar mjetet e rënda teknologjike si dhe mjetet e bashkisë të mos nevojitet të përshkojnë distanca të largëta rrugë jashtë territorit të Bashkisë pasi do kemi kosto karburanti nëse mjetet e bashkisë do të furnizohen në një pikë karburanti me distancë të largët nga Bashkia .

Në konceptimin e këtij kriteri AK ka pasur në konsideratë arsyetimin dhe llogjikën e përdorur ndër vite nga SHT e argumentuar kjo me faktin që pjesa më e madhe e aktiviteteve të bashkisë apo shërbimeve për mbarevajtjen e punimeve të tij ndodhin brenda hapësirës juridike të Bashkisë së Roskovecit dhe për pasojë pike furnizimi me karburant e kërkuar për këtë bashki është i domosdoshëm dhe i justifikueshëm nga pikëpamja operative dhe krahasuar eksperiencave të mëparshme.

2.3.6- Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neni ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26, pika 1e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI (Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial), që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilesive për vitin e fundit.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues nuk është penalizuar nga autoritetet përkatëse për abuzim me cilësinë e karburanteve, duke ofruar një garanci se nuk do të ketë të tilla abuzime as me sasinë e karburantit të prokuruar. Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Per dokumentet ne gjuhe te huaj te respektohen dispozitat sipas legjislacionit ne fuqi.

- ❖ ***Për Loti 2 kriteret e kualifikimit si më poshtë: Vaj dhe graso për (Bashkin Roskovec,Ndërmarrjen e Pastrim Gjellbërimit Mirëmbajtjes Varrezave dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirmbajtjesë)***

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formulari i Ofertës sipas Shtojcës 1;*
- b. *Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit sipas Shtojcës 2;*
- c. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- d. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Këto kriteret janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte.Gjithashtu këto kriteret janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- a. **Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8.**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 40, pika 5, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

. Keto kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021,2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo **më të ulët** se 250 000 lekë pa tvsh.*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

Argumentimi i AK : Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 në zbatim të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik"; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia ROSKOVEC, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore" (i ndryshuar), Neni 5, gërma "c" ku citohet se: "...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të lotit që po prokurohet, ose konkretisht në një vlerë jo më ulët se 130 000 lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 ose ekuivalente të vlefshëm që i referohet objektit të prokurimit.

Çertifikatat të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.

Argumentimi ligjor dhe i AK : Referuar nenit 40 pika 6/c, dhe 44 pika 1 të VKM 285 datë 19.05.2021. Ky certifikim tashmë një standart gjerësisht i kërkuar në fushën e prokurimeve publike, i mundëson AK për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë kontratën në mënyrë cilësore. Ky kriter i siguron AK se OE që do të shpallet fitues është i certifikuar sipas këtij standarti, rezulton një kompani serioze e certifikuar në menaxhimin e cilësisë.

2.3.3- Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës*

të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neni ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26, pika 1e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor, **nr.UP.03, datë.26.01.2023**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **“Blerje karburant ,vaj dhe graso për (Bashkin Roskovec, Ndërmarrjen e Pastrim Gjelbërimit Mirëmbajtjes Varrezave dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirmbajtjesë)”** me fond limit total prej: **13 787 539 (trembëdhjetë milionë e shtatëqindë e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqindë e tridhjetë e nëntë) lekë pa tvsh**, vënë në dispozicion nga të ardhurat e bashkisë, ndarë në lote si më poshtë:

Loti 1 “**Karburant për (Bashkin Roskovec, Ndërmarrjen e Pastrim Gjelbërimit Mirëmbajtjes Varrezave dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirmbajtjesë)**”,

Loti 2 “**Vaj dhe graso për (Bashkin Roskovec, Ndërmarrjen e Pastrim Gjelbërimit Mirëmbajtjes Varrezave dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirmbajtjesë)**”,

Loti 1- me fond limit prej: **13 127 939 (trembëdhjetë milionë e njëqindë e njëzetë e shtatë mijë e nëntëqindë e tridhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.**

Loti 2- me fond limit prej: **659 600 (gjashtëqindë e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqindë) lekë pa tvsh**, loji i procedurës: **“E Hapur” - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat nga data e nënshkrimit të kontratës/kontratave, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda 12 (dymbëdhjetë) muaj sipas Marrëveshjes Kuadër.**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Anëtarët pranuan dokumentacionin teknike të hartuara nga Komisioni i posacëm :**KLLFLST(Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike)** i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontrakt **nr.10699prot,datë 27.02.2022**,duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për mallin që do të blejë.

Argumentimi:Preventivat janë hartuar nga specialistet e fushës konkretisht nga KLLFLST,dorëzuar preventivat me procesverbalet e komisionit nr. 10699/1prot,datë18.01.2023,dhe shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha mallrave Komisioni për hartimin e preventivit është referuar buletinit te APP nr 4,date 16 janar 2023 .

PREVENTIVAT:

Loti 1 “Karburant për (Bashkin Roskovec,Ndërmarrjen e Pastrim Gjellbërimit Mirëmbajtjes Varrezave dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirëmbajtjesë)”,

NR	EMERTIMI	NJ.MATJES	SASIA
I	BORDI I KULLIMI		
1	Nafte D2	litra	18,315
2	Benzin	litra	-
	Shuma I		
II	Arsim+MNZ+IMT		
1	Nafte D2	litra	12,235
	Benzin	litra	-
	Shuma II		

III	NDERMARJA E SHERBIMEVE TE MIREMBAJTJES		
1	Naftë D2	litra	11,446
2	Benzin	litra	150
	Shuma III		
IV	NDERMARJA E PASTRIM GJELBERIMIT		
1	Naftë D2	litra	23,688
2	Benzin	litra	2,500
	Shuma IV		
V	Bashkia		
	Naftë D1	litra	10,078
	Benzin	litra	-
	Shuma V		
	SHUMA I-V		
	tvsh 20%		
	TOTALI :		

Loti 2"Vaj dhe graso për (Bashkin Roskovec,Ndërmarrjen e Pastrim Gjëlberimit Mirëmbajtjes Varrezave dhe Ndërmarrjen e Shërbimeve të Mirmbajtjesë)",

NR	EMERTIMI	NJ.MATJES	SASI
I	BORDI I KULLIMI		
1	Vaji motori 15/40	litra	50
2	Vaji hidrauliku 68	litra	240
3	vaji motori 20/50	litra	30
4	vaji motori 5/40	litra	15
5	vaji mishel	litra	5
6	antifrizë	litra	40
7	graso	kg	70
	Shuma I		
II	Arsim+MNZ+IMT		
1	Vaji motorri SAE 15/40	litra	50
	Shuma II		
III	NDERMARJA E SHERBIMEVE TE MIREMBAJTJES		
1	graso	kg	20
2	Vaji hidrauliku 68	litra	250
	Shuma III		
IV	NDERMARJA E PASTRIM GJELBERIMIT		
1	Vaji motori 15/40	litra	100
2	Vaji hidrauliku 68	litra	60
3	vaji motori 20/50	litra	80
4	vaji mishel	litra	50

5	Vaji motori 10/40	litra	120
	Shuma IV		
	SHUMA I-IV		
	tvsh 20%		
	TOTALI :		

Afatet e lëvrimit:

Lëvrimi i mallit do të bëhet sipas nevojave dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor nga data e nënshkrimit të kontratës, brenda 12(dymbëdhjetë) muaj, sipas Marrveshjes Kuadër.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do të paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT: